

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## MESAZHI I KRYETARIT TË DHOMËS SË BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE NË PËRFUNDIM TË NJË VITI TË "PAZAKONTË"!

Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare z.Ardian Lekaj, ka dhënë një mesazh në ditën e Diasporës në Shqipëri në mbyllje të një viti të "pazakontë". Nëpërmjet këtij mesazhi z.Lekaj ka shprehur mirënjohjen për te gjithë mbështetjen që Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka marrë gjatë këtij viti, si dhe ka ndarë qëllimet për të ardhmen. "Rrugëtimi ynë si ndërtues të urave lidhëse midis diasporës shqiptare kudo që ndodhet në botë dhe vendit amë sapo ka filluar. Të jesh anëtar i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare nuk është vetëm pasion dhe dashuri për vendin tënd, por edhe privilegj dhe përgjegjësi. . Këtë periudhë e shfrytëzuam për tu njohur me njëri-tjetrin, për të diskutuar për mundësitë ekzistuese dhe për të arkitektuar hapat drejt së ardhmes".

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## PREZANTOHET PLATFORMA "CONNECT ALBANIA"

Në 18 Dhjetor 2020, në Ditën Kombëtare të Diasporës në Shqipëri dhe Ditën Ndërkombëtare të Migracionit në botë prezantohet platforma, "Connect Albania". Ky është një model i njohur ndërkombëtar për vendet me Diasporë të konsiderueshme. "Connect Albania" është një program i ri i cili do të përdoret në Shqipëri dhe po prezantohet në një takim online të organizuar nga Zyra e IOM në Tiranë, në kuadrin e Programit "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë". I pranishëm në aktivitetin promovues ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko tha se ky projekt i jep më shumë ngjyrë ditës kombëtare të Diasporës, duke e konsideruar një vlerë të shtuar për diasporën shqiptare. Programi "Connect Albania" do të funksionojë pranë Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare dhe do të angazhojë si agjentë zhvillimi anëtarët e Diasporës Shqiptare në të gjithë botën, me një fokus të veçantë fillimisht në diasporën shqiptare e cila jeton në Itali.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## DIASPORA NË SHIFRAT E 2020

Migrimi i shqiptarëve jashtë vendit nuk është një dukuri e re. Ai është i dokumentuar të paktën që në shekujt e pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë, me largimin e një mase të madhe banorësh nga trevat shqiptare. Akoma vazhdon të mbetet veprues dhe të japë impaktet e tij domethënëse, si në aspektet demografike, po ashtu edhe ato sociale dhe ekonomike të vendit. Periudhat kohore të formimit të diasporës shqiptare ndryshojnë. Ende nuk përlloritet një shifër e saktë e diasporës shqiptare për shkak të kompleksitetit që e karakterizon këtë fenomen. Në vitin 2020, sipas vlerësimeve të tërthorta, numri i diasporës së re llogaritet të jetë rreth 1,68 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 37 % të shtetasve shqiptarë. Ky publikim kryhet nga INSTAT në kuadër të Strategjisë së Diasporës.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## JAVA NË LAJME

URIMI I MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN, PANDELI MAJKO, PËR DITËN E DIASPORËS SHQIPTARE



STRATEGJIA KOMBËTARE PËR DIASPORËN DHE PLANI I VEPRIMIT 2018-'24



STATISTIKAT, KY SHTET NË SHBA KA MË SHUMË SHQIPTARË



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	100.4	101.3
EUR	123.1	123.7
CHF	113. <sup>2</sup>	114.3
GBP	135.3	136.3
DKK	16. <sup>22</sup>	16.62